



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pzd.nr.106/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit B. (S.) M., nga fshati Sh., komuna e L., për shkak të veprës penale grabitja në bashkëkryerje dhe në tentativë, nga neni 317 par.3 lidhur me nenin 31 e 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të dënuarit, për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 10.10.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit B. M., për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda PKR.nr.265/2023 të datës 21.08.2023.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.265/2023 e datës 21.08.2023, të dënuarin B. M., për veprën penale grabitja në bashkëkryerje dhe në tentativë, nga neni 317 par.3 lidhur me nenin 31 e 28 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 05.11.2022 deri më datë 17.08.2023.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.704/2023 e datës 28.06.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësi të të dënuarit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit B. M., avokat Veton Rrecaj nga P., me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën dhe të dënuarit t'ia zbusë dënimin.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KZJD.nr.106/2024 datë 01.10.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me parashtrësën KP.nr.316/2024, e datës 13.09.2024, kjo gjykatë e ka njoftuar Prokurorin Themelore në Prishtinë që të deklarohet, mirëpo e njëjta nuk është deklaruar rreth kësaj kërkesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, propozimet e lartë cekura dhe gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashihet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënimin më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikonin në një dënim më të butë, gjithnjë duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Në kërkesën e tij mbrojtësi i të dënuarit ka theksuar se pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, janë paraqitur rrethana të reja e të cilat kanë ndikim në shqiptimin e një dënimi më të butë. Si rrethanë të re thekson gjendjen shëndetësore e të dënuarit, pasi që i njëjti vuan nga sëmundjet psikike, ashtu që sipas rekomandimit të psikiatrit duhet terapi e vazhdueshme, njëherit edhe i ati i tij ka probleme shëndetësore me zemër. Kërkesës i ka bashkangjitur raportet nga Ordinanca Psikiatrike “Panacea” në emër të të dënuarit të datës 30.07.2024 e 26.08.2024, si dhe raportin në emër të atit të dënuarit të lëshuar nga QMF datë 27.07.2024.

Nga shkresat e lëndës del se gjykatat e instancave më të ulëta me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit kanë vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit. Rrethanat në të cilat thirret mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë e të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit por që konsiderohen si rrethana të reja, nuk e kanë intensitetin e tillë që të ndikojnë në zbutjen e dënimit, e as që mund të karakterizohen si rrethana që e arsyetojnë shqiptimin e një dënimi më të butë. Në anën tjetër, nga raportet mjekësore - psikologjike del se të dënuarit i janë ofrua shërbime mjekësore, është caktuar diagnoza me rekomandim që të përdor terapi dhe konsulta të herëpashershme. Ndërsa nga raporti mjekësor në emër të babait të dënuarit del se ai ka marrë shërbim mjekësor ambulator ku i është caktuar diagnoza dhe i është rekomandua terapia.

Andaj, rrethanat të cilat ceken në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e kanë karakterin e rrethanave nga dispozita e nenit 429 të KPP-së, të cilat do të ishin bazë për aprovimin e kërkesës.

Nga sa u tha më lartë, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.7 të KPPK-së, vendosi si në dispozitivë të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pzd.nr.106/2024, më datë 10.10.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Afrim Shala